



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1067 Prot.

3

Tiranë, më 4 11 2016

REKOMANDIM

Nr. 27 datë 4 11 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Zyra e Komisionerit ka kryer hetim administrativ në ngarkim të kontrolluesit "Sar'Otel" – A&G 12 sh.p.k. Tiranë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik.

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhërit Nr.213, datë 05.10.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dalë për realizimin e këtij hetimi administrativ, nga grupi i inspektimit u realizua kontrolli pranë kontrolluesit "Sar'Otel" – A&G 12 sh.p.k. Tiranë, konform procedurave administrative, me objekti kontrolli si më poshtë:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "Sar'Otel".

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhërin Nr.213, datë 05.10.2016 të Komisionerit.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi nuk e kishte kryer "Njoftimin" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, por e përmbushi këtë detyrim menjëherë pas fillimit të hetimit administrativ pranë tij.
2. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet në të cilat ushtron aktivitet, nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Konstatohet se kontrolluesi nuk ka marrë masa për informimin e subjekteve të të dhënave në lidhje me mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, nëpërmjet këtij sistemi.
3. Kontrolluesi mban një fotokopje të pasaportës në momentin e regjistrimit të klientit në hotel dhe kjo ruhet e skanuar për një periudhë të pacaktuar.

4. Kontrolluesi nuk kishte rregullore të posaçme për mbrojtjen e të dhënave personale, por e përmbushi këtë detyrim menjëherë pas fillimit të hetimit administrativ pranë tij.
5. Kontrolluesi nuk aplikon politikat e privatësisë në portalin <http://www.sarotel.com> në lidhje me të dhënat personale që përpunohen nëpërmjet këtij portali.

Konstatimet e mësipërme përbëjnë shkelje të neneve 6, 18, 21 dhe 27 të Ligjit Nr. 9887 për "Mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

**Në cilësinë e provës materiale, procesverbalit të inspektimit ju bashkëngjiten dokumentet:**

- Kontratë individuale pune.
- Fotografi të ambienteve.
- Ekstrakt i QKR-së.
- Printime nga portali <http://www.sarotel.com>.
- Lista e punëmarrësve.
- Rregullore e funksionimit të Sar'Otel.

Në përmbyllje të procesit administrativ, në pranë të përfaqësuesve të kontrolluesit u hartua dhe lexua procesverbali i mbajtur për këtë rast. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk paraqitën pretendime.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", datë 30.04.2015, përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi "Sar'Otel" – A&G 12 sh.p.k., Tiranë, është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancën dëgjimore që do të zhvillohej në datën 25.10.2016, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar.

Përfaqësuesit e kontrolluesit në këtë seancë dëgjimore paraqitën prova, të cilat demonstronin riparimin e shkeljeve të konstatuara, të cilat konsistojnë në:

- "Njoftimin" pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me përpunimin e të dhënave (në zbatim të nenit 21 të ligjit).
- Hartimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë ushtrimit të aktivitetit të kontrolluesit.
- Vendosjen e tabelave informuese në ambientet në të cilat kontrolluesi ushtron aktivitetin, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).

Zyra e Komisionerit, vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e hetimit, i cili ka qenë i ndërsjellë në funksion të zbatimit të ligjit.

Sa më sipër:



Në zbatim të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe në kuadër të gjetjeve të hasura pranë këtij kontrolluesi,

### REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Sar'Otel" – A&G 12 sh.p.k., Tiranë, në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha proceset e reja të mundshme në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
2. Kontrolluesi "Sar'Otel" – A&G 12 sh.p.k., Tiranë, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masat për të përfshirë në faqen e tij të internetit rubrikën "Politikat e Privatësisë".
3. Kontrolluesi "Sar'Otel" – A&G 12 sh.p.k., Tiranë, duhet të realizojë detyrimet rekomanduese të këtij akti, në vazhdimësi për pikën e parë të këtij rekomandimi dhe, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dalja e tij, për pikën e dytë.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 4 . 11 .2016

